	<p><b>Megjithatë, ende nuk ka një memorandum mirëkuptimi midis KLSH-së dhe Parlamentit, për krijimin e një nënkomisioni të dedikuar për ndjekjen e auditimeve të KLSH.</b> KLSH paraqet raportet e tij kryesore (raporti vjetor, raporti i buxhetit) në Komisionin e Ekonomisë dhe Buxhetit të Parlamentit. <b>Autoritetet treguan se nuk ka ende një afat kohor për të përmirësuar rregullsinë në raportim dhe bashkëpunim me Parlamentin.</b></p> <p><b>Sa i përket ndikimit të punës së auditimit, niveli i zbatimit të rekomandimeve të auditimit të jashtëm është ende i pamjaftueshëm, pavarësisht nga një shkallë e lartë e rekomandimeve të pranuar nga institucionet. Shqyrtimi parlamentar i organeve të audituara në zbatimin e rekomandimeve është ende i kufizuar dhe duhet të rritet, përmes seancave më të shpeshta parlamentare dhe krijimit të një kuadri monitorues parlamentar për të vlerësuar rregullisht veprimet vijuese të qeverisë.</b></p>		<p>institucionet e pavarura (Afati: 2024-2029)</p> <p>-Organizimi i seancave dëgjimore nga Komisionet parlamentare për shqyrtimin e raporteve; (Afati: 2024-2029)</p>		
	<p><b>Përpjekjet mbeten të nevojshme për të trajtuar ndikimin e polarizimit politik në efektivitetin e parlamentit.</b></p>	<p>-.Përmirësimi i dialogut politik me qëllim minimizimin e ndikimit të polarizimit politik në efektivitetin e Kuvendit përmes organizimit të takimeve periodike midis Kryetarit të Kuvendit dhe kryetarëve të grupeve parlamentare, për diskutimin e çështjeve që kërkojnë një konsensus të gjerë Afati: 2024-2029</p> <p>-.Organizimi i takimeve periodike të KKIE për sigurimin e dialogut politik në procesin e integritetit evropian (Afati: 2024-2029)</p>	<p>Kuvendi Kryetarja e Kuvendit Kryetarët e Grupeve parlamentare</p> <p>KKIE</p>	<p>Grantimi i efektivitetit të Kuvendit</p>	<p>Numri i takimeve të Kryetarëve të grupeve parlamentare</p> <p>Nr i takimeve periodike të KKIE.</p>
	<p>Kushtetuta e Shqipërisë <b>duhet të garantojë me anëtarësimin respektimin e parimit të përparësisë së ligjit të BE-së ndaj të gjitha dispozitave të kundërta të ligjit kombëtar</b>, nga institucionet demokratike, përfshirë Parlamentin, Qeverinë, si dhe nga autoritetet gjyqësore, përfshirë Gjykatën Kushtetuese</p>	<p>Ndryshimi i Kushtetutës garantojë me anëtarësimin respektimin e parimit të përparësisë së ligjit të BE-së ndaj të gjitha dispozitave të kundërta të ligjit kombëtar, nga institucionet demokratike, përfshirë Parlamentin, Qeverinë, si dhe nga autoritetet gjyqësore, përfshirë Gjykatën Kushtetuese (Afati: 6 muaj para anëtarësimin)</p>	<p>Deputetët Këshilli për legjislacionin Komisioni i ligjeve Shërbimi legjislativ Seanca plenare</p> <p>-.Hartimi i ndryshimeve kushtetuese (Afati: 1 vit para anëtarësimin)</p> <p>-.Miratimi në seancë plenare (Afati: 6 muaj para anëtarësimin)</p>	<p>Garantimi i supremacisë së legjislacionit evropian mbi atë vendas duke përfshirë dhe vetë Kushtetutën</p>	<p>Ndryshimet kushtetuese të miratuara.</p>
<p><b>C) REFORMA E ADMINISTRATËS PUBLIKE</b></p>	<p><b>a. Prezantimi i vendit</b> Përveç projektligjeve me ndikim buxhetor, <b>nuk ka asnjë kërkesë ligjore për të siguruar që Qeveria të shqyrtojë sistematikisht të gjitha projektligjet iniciuar nga Parlamenti.</b></p> <p><b>(Vlerësimi i KE)</b></p>	<p>Ndryshimi i Rregullores së Kuvendit për vendosjen e detyrimit të konsultimit të projektligjeve të iniciuara nga deputetët jo vetëm për ato që kanë një impakt financiar por për të gjitha projektaktet. (Afati 2024)2</p>	<p>Deputetët Këshilli për mandatet, rregulloren dhe Imunitetin Komisioni i ligjeve Shërbimi legjislativ</p>	<p>Përmirësimi i harmonizimit ligjor dhe sigurimi i përputhshmërisë me kuadrin ligjor në fuqi i iniciativave ligjore të</p>	<p>Ndryshimet e rregullores së Kuvendit të miratuara.</p>

<sup>2</sup> Bazuar në VKM Nr. 27, datë 23.1.2019 mbi fushën e përgjegjësisë të Ministrisë së Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin i ngarkon këtij të fundit detyrën për të ndjekur të gjitha iniciativat ligjore në parlament, dhe në mënyrë specifike ato nisma që vijnë nga deputetë apo 20.000 zgjedhës. Konkretisht pikat III/4,7,8 e VKM Nr. 27, datë 23.1.2019 e parashikojnë kontributin e qeverisë edhe në nismat ligjvënese që lindin në Kuvend apo nga zgjedhësit por ky detyrim nuk

<p><b>II. ZHVILLIMI DHE BASHKËKORDINIMI I POLITIKAVE</b></p>	<p><i>Rregullat ekzistuese nuk kërkojnë që Qeveria të shqyrtojë projektligjet e iniciuara nga anëtarët e parlamentit në mënyrë sistematike, dhe as Qeveria nuk e bën këtë në baza të rregullta, gjë që mund të çojë në mospërputhje në legjislacion dhe politika.</i></p> <p>Në periudhën e ardhshme, <b>Kuvendi</b> planifikon të përmirësojë zbatimin e mekanizmave të kontrollit <b>duke rritur numrin e seancave dëgjimore në komisionet parlamentare, numrin e vizitave në terren dhe gjetjet e fakteve nga anëtarët e komisioneve parlamentare dhe duke zhvilluar përdorimin të pyetjeve, interpelancave, mocioneve me debat dhe kërkesave me shkrim për informacion drejtuar qeverisë dhe institucioneve të saj në varësi.</b></p> <p><b>Vlerësimi i KE</b></p> <p>Në praktikë, <b>Parlamenti</b> rrallë diskuton dhe vlerëson zbatimin e ligjeve dhe politikave qeveritare. <b>Roli i mbikëqyrjes parlamentare të performancës së qeverisë, duke përfshirë agjencitë e varura, mbetet ad-hoc dhe duhet të rritet.</b> Shqipëria duhet të përforcojë rolin e mbikëqyrjes parlamentare të qeverisë. Legjislacioni për shqyrtimin adekuat parlamentar të politikëbërjes së Qeverisë është pjesërisht në fuqi. <i>Aktualisht në rishikim, Ligji për Rolin e Parlamentit duhet të forcojë rolin e Parlamentit, të përforcojë koordinimin ndërmjet Parlamentit dhe Qeverisë dhe të rregulloj diskutimin dhe vlerësimin e ligjeve të sponsorizuara nga Qeveria në Parlamentin.</i></p>	<p>Përmirësimi i përdorimit të instrumentave të kontrollit nga ana e deputetëve si në seancë plenare dhe në Komisioneve parlamentare duke përfshirë këtu dhe Komisionet posacme ato hetimore sa i përket kontrollit të veprimtarisë së qeverisë dhe institucioneve të saja të varësisë në procesin ligjberës dhe kontrollues. (Afati: 2024-2029)</p>	<p>Hartimi dhe miratimi i ndryshimeve në Rregulloren e Kuvendit (Afati 2024)</p> <p>Deputetët Komisionet parlamentare Seanca plenare Shërbimet e Kuvendit</p> <p>Përmirësimi në zbatimin e mekanizmave të kontrollit <i>duke rritur:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- numrin e seancave dëgjimore në komisionet parlamentare;</li> <li>- numrin e vizitave në terren;</li> <li>- përdorimin e pyetjeve,</li> <li>- përdorimin e interpelancave,</li> <li>- mocioneve me debat;</li> <li>- kërkesave me shkrim për informacion drejtuar qeverisë dhe institucioneve të saj në varësi</li> <li>- përdorimin e Komisioneve hetimore;</li> <li>etj</li> <li>- Përmirësimin e punës së nënkomisioneve parlamentare sipas fushës së tyre të përgjegjësisë). (Afati: 2024-2029)</li> </ul>	<p>propozuar nga deputetët.</p> <p>Kontroll i përmirësuar dhe efektiv ndaj qeverisë dhe agjencive të saj të varësisë</p>	<p>Numri i përdorimit të instrumentave të kontrollit ndaj qeverisë si :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-numri i seancave dëgjimore</li> <li>- nr e vizitave në terren;</li> <li>-Numri i pyetjeve.</li> <li>-Nr i interpelancave.</li> <li>-Nr i mocioneve me debat;</li> <li>-Numri i kërkesave me shkrim.</li> <li>-Nr. i Komisioneve hetimore;</li> <li>-Nr i mbledhjeve të nënkomisioneve.</li> </ul>
	<p><b>IV. ORGANIZIMI DHE PËRGJEGJËSIA</b></p> <p><b>Vlerësimi i Komisionit</b></p> <p><b>Kuvendi duhet të forcojë përpjekjet në mbështetjen e aktiviteteve të institucioneve publike të pavarura me rol mbikëqyrës.</b></p>	<p>Mbështetja e aktiviteteve të institucioneve publike të pavarura me rol mbikëqyrës nëpërmjet shqyrtimit të raporteve të përcjella prej tyre si dhe pjesëmarrjes në aktivitetet që ato zhvillojnë për çështje të ndryshme. (Afati: 2024-2029)</p>	<p>Deputetët Komisionet parlamentare Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve Shërbimi legjislativ Rritja e numrit të seancave dëgjimore zhvilluar në komisionet parlamentare për diskutimin e raporteve të tyre për çështje të vecanta. (Afati: 2024-2029)</p>	<p>Mbështetja e aktiviteteve të institucioneve publike të pavarura me rol mbikëqyrës</p>	<p>Nr i seancave dëgjimore.</p> <p>Nr i raporteve të diskutuara.</p> <p>Nr i çështjeve të diskutuara</p> <p>Nr i pjesëmarrjes së deputetëve në aktivitetet e</p>

është i shprehur dhe në Rregulloren e Kuvendit.(Pika III/4 parashikon se Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin: Ndjek në mënyrë periodike ecurinë e procesit ligjberës në Kuvend, nëpërmjet procesverbaleve dhe relacioneve që përpunohen gjatë shqyrtimit të projektligjeve dhe informon Kryeministrin për problematikat që mund të dalin gjatë këtij procesi. Pika III/ 7. Ndjek ecurinë në Kuvend të projektligjeve të ndërmarra me nismën e një deputeti apo njëzet mijë zgjedhësve; a) duke bashkërenduar punën dhe duke u kujdesur për dërgimin pranë komisionit përkatës të Kuvendit të mendimeve nga ministria, në fushën e përgjegjësisë të së cilës është projektligji;b) duke vlerësuar nëse përmbajtja e tyre harmonizohet me programin politik të Këshillit të Ministrave; c) duke bashkërenduar punën me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për analizën për koston financiare që ka projektligji për buxhetin e shtetit, nëse do të ketë një efekt të tillë. Pika III/8 8. Njofton Kryeministrin për problematikat e konstatuara gjatë shqyrtimit në Kuvend të projektligjeve të ndërmarra me nismën e një deputeti apo njëzet mijë zgjedhësve).

					institucioneve të pavarura.
	<p><b>I IV. ORGANIZIMI DHE PËRGJEGJËSIA</b></p> <p><b><u>Institucionet e mbikëqyrjes janë formalisht të pavarura dhe Avokati i Popullit ushtron pushtetin e tij të kontrollit të ekzekutivit. Megjithatë, shkalla e zbatimit të rekomandimeve nga institucionet mbikëqyrëse mbetet e dobët (42% në 2021). Për më tepër, për të garantuar fuqi mbikëqyrëse efektive, mandati i Avokatit të Popullit të Shqipërisë duhet të mbulojë të gjithë ekzekutivin.</u></b></p> <p><b>Ky rekomandim gjendet dhe në Kapitullin 23/të drejtat e njeriut Shqipëria duhet të forcojë zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit.</b></p>	<p>Përmirësimi i ushtrimit të kontrollit nga ana e Kuvendit, të zbatimit të rekomandimeve të AP nëpërmjet:</p> <p>Organizimit të seancave dëgjimore me qeverinë dhe institucionet e saj të varësisë të cilat nuk zbatojnë rekomandimet e AP. (Afati 2024 - 2029)</p>	<p>Deputetët Komisionet parlamentare Seanca plenare Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve Shërbimi legjislativ</p>	<p>Zbatimi i rekomandimeve të AP nga qeveria dhe mbulimi i gjithë ekzekutivit.</p>	<p>Nr i takimeve të zhvilluara;</p>
	<p><b>IV. ORGANIZIMI DHE PËRGJEGJËSIA</b></p> <p>Kuadri i <b><u>ardhshëm legjislativ për aksesin në informacionin publik duhet të forcojë kompetencat e Komisionerit të Informacionit dhe Mbrojtjes së të Dhënave duke ofruar mekanizmat për të zbatuar vendimet dhe mandatin për të kryer inspektime gjithëpërfshirëse.</u></b><sup>3</sup></p> <p><b>Rekomandime lidhur me këtë çështje dalin dhe në Kapitulli 23/të drejtat themelore të njeriut / III.G LIRIA E SHPREHJES PËRFSHIRË LIRINË DHE PLURALIZMIN E MEDIAS</b></p> <p>Në lidhje me të drejtën për akses në informacion me interes publik, <b><i>nevojiten masa për të përmirësuar aksesin në informacion për gazetarët, përfshirë afate më të shkurtra dhe të detyrueshme për përgjigjet</i></b>, të bazuara në praktikën më të mira evropiane. Rregullat gjithashtu duhet të sigurojnë që <b><i>sanksionet të vendosen edhe ndaj titullarit të institucionit ose nëpunësve të lartë civilë në rast të keqpërdorimit dhe moszbatimit të urdhrave të Komisionerit për të Drejtën e Informimit.</i></b></p>	<p><b>Eshtë realizuar.</b></p>	<p>Deputetët Komisionet parlamentare Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve Shërbimi legjislativ</p>	<p>Forcimi i kompetencave të KMIDP me ligj.</p>	<p>Ndryshimet ligjore apo ligj i ri për të drejtën e informimit i miratuar.</p>
<p><b>D) KAPITULLI 23 - GJYQËSIA DHE TË DREJTAT THEMELORE</b></p>	<p><b><u>I. GJYQËSORI</u></b> <b><u>I.NJË VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM</u></b></p> <p><b><u>Prezantimi i vendit</u></b></p> <p>Kontrollet e vazhdueshme të përshtatshmërisë ligjore <b>dhe ndryshimet ligjore të synuara janë të nevojshme për të eliminuar pengesat ligjore dhe për të konsoliduar kuadrin ligjor për të forcuar më tej pavarësinë dhe integritetin e sistemit gjyqësor dhe të prokurorisë, për të siguruar dhënien efikase të drejtësisë, për të konsoliduar kapacitetet e institucioneve të drejtësisë dhe për të rritur besimin e publikut në drejtësi.</b></p> <p><b>Veçanërisht, dispozitat që rregullojnë procedurën e parazgjedhjes së anëtarëve jo-magjistratë të KLGJ-së dhe KLP-së duhet të përputhen me standardet e kontrollit të historikut dhe deklarimit të pasurisë që zbatohen për jo-magjistratët.</b></p>	<p>-Hartimi, diskutimi dhe futja në axhendë parlamentare të paketës së ndryshimeve të akteve ligjore në kuadër të reformës në drejtësi (Afati 2024)</p>	<p>Deputetët Komisioni i Ligjeve Grupi teknik i punës për rishikimin e disa akteve të reformës së drejtësisë në drejtim të rritjes së efikasitetit dhe funksionalitetit të sistemit të drejtësisë në bashkëpunim me ekspertë nga BE dhe OPDAT. Sekretari i Përgjithshëm Shërbimi legjislativ Shërbimi i Monitorimit të institucioneve të pavaruara</p>	<p>Paketa ligjore e miratuar e cila reflekton rekomandimet e KE.</p>	<p>Ndryshimet ligjore të propozuara në paketën e akteve të reformës në drejtësi të miratuara në seancë plenare.</p>

<sup>3</sup> Ndryshimi i ligjit për të drejtën e informimit u miratua në séancën plenare të datës 21 Shtator 2023 duke adresuar rekomandimin e KE mbi forcimin e kompetencave të KMIDP, vendosjen e sanksioneve ndaj titullarëve të institucioneve ose nëpunësve të lartë civilë në rast të keqpërdorimit dhe moszbatimit të urdhrave të Komisionerit për të Drejtën e Informimit.

<p><b>Rinovimi i anëtarësimit në KLGJ dhe KLP <sup>4</sup>duhet të ndjekë parimet e transparencës dhe pavarësisë së plotë.</b> Të gjithë anëtarët jo-magjistratë të institucioneve të drejtësisë, veçanërisht ata të emëruar në KLGJ dhe KLP, duhet t'u nënshtrohen standardeve të ngjashme të kontrollit të historisë dhe deklarimit të pasurisë të zbatueshme për magjistratët.</p> <p><b>Çdo iniciativë ligjore në sektorin e drejtësisë duhet të jetë në përputhje me acquis të BE-së dhe standardet evropiane dhe të forcojë më tej parimet e reformës në drejtësi të vitit 2016.</b></p> <p><b><u>I.B PAVARËSIA DHE PAANËSIA</u></b></p> <p><b>Megjithatë, Shqipëria duhet të trajtojë vendimin e Gjykatës Kushtetuese në lidhje me përcaktimin e pagës bazë referuese për magjistratët, duke respektuar plotësisht parimin e pavarësisë financiare të magjistratëve.<sup>5</sup></b></p> <p><b>Duhet të prezantohen ndryshime ligjore për të përforcuar integritetin e stafit pedagogjik në Shkollën e Magjistraturës, duke garantuar që ish-magjistratët e shkarkuar përmes vettingut ose që dhanë dorëheqjen para tij, të mos trajnojnë gjeneratat e ardhshme të magjistratëve.</b></p> <p><b>Në procesin e emërimit të anëtarëve të KLGJ dhe KLP, Shqipëria duhet të përforcojë parimet e integritetit, pavarësisë dhe të sigurojë konkurrencë dhe transparencë të vërtetë, veçanërisht në lidhje me anëtarët jo-magjistratë.</b></p> <p><b><u>I.D CILËSISA</u></b> <b><u>b. Vlerësimi i Komisionit</u></b></p> <p><b>Masa të mëtejshme legislative dhe institucionale janë të nevojshme për të adresuar plotësisht nevojat në zhvillim të cilësisë dhe efikasitetit të sistemeve gjyqësore dhe prokuroriale.</b></p> <p><b>Ndryshimet ligjore janë të nevojshme për të forcuar kapacitetet e Shkollës së Magjistraturës.</b> <b>Veçanërisht, Shqipëria duhet të sigurojë burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për të mundësuar funksionimin e plotë, efikas dhe të pavarur të gjyqësorit dhe garantimin e të drejtës për akses në drejtësi.</b></p> <p><b>I.E Eficenca</b> <b><u>b. Vlerësimi i Komisionit</u></b> <b>Masa të mëtejshme legislative dhe institucionale janë të nevojshme për të adresuar plotësisht nevojat në zhvillim të efikasitetit të sistemeve gjyqësore dhe prokurorisë.</b></p>	<p>-Zgjedhja e anëtarëve të KLGJ dhe KLP në përputhje me kuadrin ligjor dhe afatet ligjore si edhe duke ndjekur parimet e transparencës dhe pavarësisë. Afati: Sipas afateve ligjore.</p>	<p>-Organizimi i procedurës parlamentare për zgjedhjen e anëtarëve të KLP dhe KLGJ. (-Shpallja e thirrjeve; -Organizimi i seancave dëgjimore - Votimi në seancë plenare)</p>	<p>Zgjedhja e anëtarëve të KLGJ dhe KLP.</p>	<p>Anëtarët e KLP dhe KLGJ të zgjedhur me Vendim të seancës Plenare të Kuvendit.</p>
--	---	--	--	--

<sup>4</sup> Për zgjedhjen e anëtarëve të KLP dhe KLGJ, Komisioni Evropian në takimin e nënkomitetit të Drejtësisë, Lirisë dhe Sigurisë zhvilluar on line në dt.14-15 qershor 2023 ka **rekomanduar që zgjedhja e tyre të bëhet brenda vitit 2023, nëpërmjet një procesi transparent me qëllim përzgjedhjen e anëtarëve me integritet.**

<sup>5</sup> Ky rekomandim është reflektuar me miratimin e ligjit nr. 33/ 2023 “Për një ndryshim në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

<b>Kapitulli 23/Lufta kundër korrupsionit</b>	<p>Duhet të rishikohet kuadri legjislativ për të shtrirë kompetencën e gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar në çështjet që lidhen me ekzekutimin e vendimeve të tyre<sup>6</sup>.</p> <p><i>Kapaciteti i gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar duhet të rritet për të përmbushur nevojat operationale.</i></p>	<p>Rishikimi i kuadrit ligjor për shtrirjen e kompetencës së gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar në çështjet që lidhen me ekzekutimin e vendimeve të tyre (Afati: Pas propozimit nga KM të ndryshimeve ligjore në Kodin e Procedurës Penale)</p>	<p>Kuvendi Komisioni i Ligjeve Shërbimi juridik Seanca Plenare</p>		<p>Ndryshimet ligjore të miratuara</p>
<b>Kapitulli 23/të drejtat e njeriut</b>  <b>III.G LIRIA E SHPREHJES PËRFSHIRË LIRINË DHE PLURALIZMIN E MEDIAS</b>  <b>Vlerësimi i KE</b>	<p>Autoriteti rregullator audio-vizual AMA është plotësisht funksional, <b>por pavarësia e organit është vënë në pikëpyetje për shkak të formulës zgjedhore dypartiake dhe lidhjeve të drejtpërdrejta politike të disa prej anëtarëve të bordit të saj.</b></p> <p><b>Ligji duhet t'i garantojë AMA-s autonominë organizative dhe të forcojë emërimet e bazuara në merita të bordit dhe stafit të lartë të AMA-s.</b></p> <p>Duhet të <b>vendosen kërkesa ligjore për të adresuar përqendrimin e lartë të tregut mediatik, duke forcuar transparencën dhe duke vendosur kufizime për pronësinë e medias dhe për shtrirjen e audiencës.</b></p> <p>Shqipëria duhet të forcojë <b>rregullat për transparencën e financimit dhe pronësisë së medias, duke përfshirë interesat e pronarëve në sektorin mediatik dhe jo mediatik. Legjislacioni duhet të përfshijë mekanizma të fuqishëm zbatues, nga institucionet e pavarura për hapjen e hetimeve për shkelje të mundshme të rregullave të pronësisë, në përputhje me standardet e Këshillit të Evropës, si dhe në lidhje me interesat e pronarëve të fshehur, përqendrimin e mundshëm, sjelljen e koordinuar, konkurrencën e pandershme dhe favorët e mundshme që lidhen me shmangien e të drejtave të autorit dhe përfitimit nga reklamat shtetërore dhe fondet shtetërore.</b></p> <p><b>Ndryshimet ligjore duhet të reflektojnë, ndër të tjera, rekomandimet e Këshillit të Evropës dhe Komisionit të Venecias dhe t'i nënshtrohen konsultimeve të duhura me organizatat e medias.</b></p>	<p>Ndryshimi i ligjit për mediat audiovizive me qëllim: Garantimin e autonomisë organizative të AMA; Ndryshimit të formulës zgjedhore dypartiake të zgjedhjes së titullarit dhe anëtarëve të bordit të AMA-s; Forcimin e emërimeve të bazuara në meritë anëtarëve të bordit të AMA Vendosjen e kërkesave ligjore për të adresuar përqendrimin e lartë të tregut mediatik, duke forcuar transparencën dhe duke vendosur kufizime për pronësinë e medias dhe për shtrirjen e audiencës Forcimin e rregullave për transparencën e financimit dhe pronësisë së medias, duke përfshirë interesat e pronarëve në sektorin mediatik dhe jo mediatik. Përfshirjen e mekanizmave të fuqishëm zbatues, nga institucionet e pavarura për hapjen e hetimeve për shkelje të mundshme të rregullave të pronësisë, në përputhje me standardet e Këshillit të Evropës, si dhe në lidhje me interesat e pronarëve të fshehur, përqendrimin e mundshëm, sjelljen e koordinuar, konkurrencën e pandershme dhe favorët e mundshme që lidhen me shmangien e të drejtave të autorit dhe përfitimit nga reklamat shtetërore dhe fondet shtetërore. (Afati 2026).</p>	<p>Deputetët Komisioni i Medias Komisioni i Ligjeve Seanca plenare Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve Shërbimi legjislativ</p> <p>1.Hartimi i ndryshimeve ligjore bazuar në propozimet e AMA, vendimet e Komisionit European, Komisionit të Venecias dhe KE Afati:..2024-2025</p> <p>2.Konsultimi i projektligjit me grupet e interesit; Afati: 2025.</p> <p>3. Miratimi i ndryshimeve ligjore Afati 2026</p>		<p>Ndryshimet ligjore të miratuara nga Kuvendi për ligjin e medias ku reflektohen komentet e KE;</p>
<b>Kapitulli 23/ Të drejtat e njeriut</b>	<b>Vlerësimi i KE</b>	<p>Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesave shtesë për buxhet nga Avokati i Popullit pas rakordimit me MF.</p>	<p>Kuvendi, Komisioni i Ligjeve Komisioni i Ekonomisë</p>	<p>Institucione të pavarura me kapacitete të mjaftueshme për</p>	<p>Miratimi i ligjit të buxhetit që</p>

<sup>6</sup> Në ndryshimet kushtetuese, të miratuara nëpërmjet ligjit nr.76/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, (të ndryshuar), ndër të tjera, në nenin 135 të saj, është parashikuar ngritja e Gjykatës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Kushtetuta i referohet ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar” ku ky i fundit parashikon se **kompetenca lëndore e Gjykatave Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, parashikohet nga neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale nuk mund të tejkalojë kompetencën e përcaktuar nga neni 135/2 i Kushtetutës.** Ky ligj përcakton juridiksionin penal të Gjykatës Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, e cila do të jetë me vendndodhje në Tiranë dhe e ushtron juridiksionin e saj penal në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

	<p>Është e një rëndësie të veçantë <b><i>që të forcohen kapacitetet e organeve të pavarura të të drejtave të njeriut, duke përfshirë Avokatin e Popullit (AP), Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.</i></b></p>	<p>(Afat: sipas kërkesës së Avokatis të Popullit në Kuvend)</p>	<p>Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve Shërbimi legjislativ Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesave shtesë për buxhet nga Avokati i Popullit pas rakordimit me MF. Afati: (sipas kërkesës së AP në Kuvend).</p>	<p>zbatimin e kompetencave ligjore</p>	<p>adreson kërkesat e AP.</p>
<p><b>III.E MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE</b></p>	<p>Shqipëria duhet të <b><i>harmonizojë ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale me Rregulloren e Përgjithshme të BE-së për Mbrojtjen e të Dhënave 2016/679 dhe Direktivën e Zbatimit të Ligjit 2016/680.</i></b> Ligji duhet të sigurojë autonominë organizative të Komisionerit për Mbrojtjen e Informacionit dhe të Dhënave (IDP) dhe ta fuqizojë atë për të miratuar vendime detyruese.</p> <p>Për sa i përket <b>zbatimit, duhet të rriten kapacitetet dhe kompetencat e Komisionerit të IDP-së</b> nëse kërkohet që ai të trajtojë në mënyrë efektive përgjegjësitë e reja që rrjedhin nga ligji i ri i prishëm për mbrojtjen e të dhënave personale.</p>	<p>Diskutimi dhe miratimi i ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale që përfaqësojnë Rregulloren e Përgjithshme të BE-së për Mbrojtjen e të Dhënave 2016/679 dhe Direktivën e Zbatimit të Ligjit 2016/680 (Afat: <i>Pas propozimit nga KM</i>)</p> <p>2.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesave për buxhet nga KMIDP pas rakordimit me MF. (Afat: pas miratimit të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe sipas kërkesës me KMIDP).</p>	<p>Kuvendi Komisionet parlamentare Shërbimi legjislativ Shërbimi i monitorimit të Institucioneve Shërbimi i Përafrimit të Legjislacionit</p> <p>1.Diskutimi dhe miratimi i ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale që përfaqësojnë Rregulloren e Përgjithshme të BE-së për Mbrojtjen e të Dhënave 2016/679 dhe Direktivën e Zbatimit të Ligjit 2016/680 (Afat: <i>Pas propozimit nga KM</i>).</p> <p>2. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesave për buxhet nga KMIDP. (Afat: pas miratimit të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe sipas kërkesës me KMIDP).</p>	<p>Ligj i përafruar me <i>Rregulloren e Përgjithshme të BE-së për Mbrojtjen e të Dhënave 2016/679 dhe Direktivën e Zbatimit të Ligjit 2016/680</i></p>	<p>1.Ligj i miratuar në seancë plenare</p> <p>2.Miratimi i ligjit të buxhetit që adreson kërkesat e KMIDP.</p>
<p><b>III.I.1 Mosdiskriminimi</b></p>	<p><b><i>Duhet të miratohen ndryshime ligjore për të forcuar pavarësinë e transmetuesit publik,</i></b> veçanërisht për të siguruar që rregullatori të ketë një përbërje pluraliste, të <b><i>përbëhet nga individë të kualifikuar, të përfaqësojë komunitetin e medias dhe të gëzojë autonomi nga qeveria dhe kontrolli i korporatës.</i></b></p>	<p>Ndryshimi i ligjit për mediat audiovizive me qëllim për të <b><i>forcuar pavarësinë e transmetuesit publik</i></b> Afati: 2026.</p>	<p>Deputetët Komisioni i Medias Komisioni i Ligjeve Seanca plenare Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve Shërbimi legjislativ</p> <p>1.Hartimi i ndryshimeve ligjore Afati: 2024/2025.</p> <p>2.Konsultimi i projektligjit me grupet e interesit; Afati:2025.</p>		<p>Ndryshimet e ligjit të mediave audiovizive të miratuara.</p>
<p><b>III.G LIRIA E SHPREHJES PËRFSHIRË LIRINË DHE PLURALIZMIN E MEDIAS</b></p> <p><b>Vlerësimi i KE</b></p>					

			3. Miratimi i ndryshimeve ligjore Afati:2026.		
<b>III.G LIRIA E SHPREHJES PËRFSHIRË LIRINË DHE PLURALIZMIN E MEDIAS</b>  Vlerësimi i KE	Mbeten për t'u plotësuar që nga qershori 2023 1 vende vakante në bordin e RTSh.	Zgjedhja e anëtarit të bordit të RTSH brenda 2024.	Deputetët Komisioni i Medias Komisioni i Ligjeve Seanca plenare Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve Shërbimi legjislativ  1.Organizimi i procedurës dhe zgjedhja e anëtarëve të RTSH. Afati 2024		Anëtarët e zgjedhur me Vendim të seancës plenare
<b>IV. TË DREJTAT E SHTETËSISË TË BE-së</b>	Kuadri ligjor dhe institucional nuk është në përputhje me acquis të BE-së për të drejtat e qytetarëve të BE-së. Shqipëria <b>duhet të sigurojë përafrimin e plotë të kuadrit të saj legjislativ me acquis të BE-së për të garantuar gëzimin e plotë të të gjitha të drejtave të shtetësisë së BE-së pas anëtarësimit. Shqipëria duhet të përmbahet nga zhvillimi dhe zbatimi i një skeme të fitimit të nënshtetësisë nëpërmjet investimit.</b>	-Ndryshimi i Kushtetutës. Afati: 6 muaj deri në 1 vit para anëtarësimit në BE.  -Ndryshimi i Kodit Zgjedhor. Afati: 6 muaj deri në 1 vit para anëtarësimit në BE.	Kuvendi Komisionet parlamentare Këshilli për Legjislacionin Këshilli për Rregulloren dhe mandatet Shërbimi legjislativ Shërbimi i Përafrimit të Legjislacionit	Garantimi dhe gëzimi i plotë të të gjitha të drejtave të qytetarëve që kanë nënshtetësinë së BE-së  Garantimi i të drejtës për të zgjedhur dhe për tu zgjedhur në zgjedhjet për në Parlamentin Europian dhe në zgjedhjet vendore.	Ndryshimet kushtetuese të miratuara  Ndryshimet e Kodit Zgjedhor të miratuara  Ndryshimet e Rregullores së Kuvendit të miratuara.
<b>Kapitulli 32/ Kontrolli financiar/Auditimi i brendshëm</b>	<b>Ligji për auditimin e brendshëm (AB)</b> është përgjithësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare. Megjithatë, <b>kuadri rregullator duhet të adresojë boshllëqet e mbetura legjislative dhe rishikimi i ligjit (aktualisht në rishikim nga Parlamenti) duhet të parashikojë vendosjen e procedurave të qarta të rolit dhe funksionit të auditimit të brendshëm kur identifikohen dhe raportohen parregullsitë ose mashtrimet dhe rastet e korrupsionit.</b>  <b>Rishikimi duhet të rrisë edhe angazhimin e drejtuesve për koordinim, komunikim dhe raportim periodik në lidhje me arritjen e objektivave dhe treguesve të performancës ndërmjet institucioneve dhe njësisve vartëse të tyre.<sup>7</sup></b>	<b>Realizuar</b>			
<b>Auditimi i jashtëm</b>	<b>Megjithatë, ende nuk ka një memorandum mirëkuptimi midis KLSH-së dhe Parlamentit, për krijimin e një nënkomisioni të dedikuar për ndjekjen e auditimeve të KLSH.</b> KLSH paraqet raportet e tij kryesore (raporti vjetor, raporti i buxhetit) në Komisionin e Ekonomisë dhe Buxhetit të Parlamentit. <b>Autoritetet</b>	Përmirësimi i kontrollit parlamentar në drejtim të zbatimit të rekomandimeve të KLSH në institucionet e audituara	Komisionet parlamentare Shërbimi i monitorimit të institucioneve	Kontroll parlamentar i përmirësuar në drejtim të organeve të audituara	Nr i seancave dëgjimore të zhvilluara;

<sup>7</sup> Ndryshimet e këtij ligji janë miratuar me ligjin nr.12, datë 2.2.2023 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 114, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" i cili, sipas analizës juridike nga Shërbimi i Komisioneve ka reflektuar komentet e Komisionit Europian.



	<p><b>prezantuan se nuk ka ende një afat kohor për të përmirësuar rregullsinë në raportim dhe bashkëpunim me Parlamentin.</b></p> <p>Shqipëria duhet të rrisë nivelin e zbatimit të rekomandimeve të auditimit të jashtëm dhe <b>të zhvillojë kontrollin parlamentar të institucionet të audituara.</b></p> <p><b>Shqyrtimi parlamentar i organeve të audituara në zbatimin e rekomandimeve është ende i kufizuar dhe duhet të rritet,</b> përmes seancave më të shpeshta parlamentare dhe krijimit të një kuadri monitorues parlamentar për të vlerësuar rregullisht veprimet vijuese të qeverisë.</p>	<p>Krijimi dhe funksionimi i një nënkomisioni të dedikuar për ndjekjen e auditimeve të KLSH. Afati 2024</p>	<p>-Organizimi i seancave dëgjimore me institucionet e audituara mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të të KLSH-ës. Afati; 2024-2029</p> <p>-Monitorimi në vijim e zbatimit të këtyre rekomandimeve pas zhvillimit të seancave dëgjimore me institucionet përgjegjëse Afati: 2024-2029</p>		
--	---	---	--	--	--